



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:018717

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05771595

PKR.nr.227/2014

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Krimeve të Rënda, Kryetari i Trupit Gjykes – Gjykatësi **Sulltan Dobraj**, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Nushe Kadrija në çështjen penale kundër të pandehurit G. Sh. nga fsh. . . k-Rahovec, për shkak të veprës penale dëmtim i kreditorëve apo debitorëve nga neni 235 paragraf 3 lidhur me paragraf 1 të KPK (UNMIK/RREG/2003/25), dhe dy veprave penal te mashtrimit nga neni 261 paragraf 2 lidhur me paragraf 1 të KPK (UNMIK/RREG/2003/25), sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë PP/I.nr.05/2013 të datës 10.11.2014 të dorëzuar dhe pranuar ne gjykate me dt.11.11.2014, jashtë shqyrtimit gjyqësor, konform nenit 229 të KPPK UNMIK/RREG/2003/26, nenit 441, 453, 462 paragraf 3 të KPPK-së ([KODI NR. 08/L-032](#)), me datë 27.05.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HUDHET – Parashtrësia** - Aktakuza e Prokurorisë Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë PP/I.nr.05/13 të datës 11.11.2014, e parashtruar kundër të pandehurit G. Sh. nga fsh. . . k-Rahovec, për shkak të veprës penale dëmtim i kreditorëve apo debitorëve nga neni 235 paragraf 3 lidhur me paragraf 1 të KPK (UNMIK/RREG/2003/25), dhe dy veprave penal te mashtrimit nga neni 261 paragraf 2 lidhur me paragraf 1 të KPK (UNMIK/RREG/2003/25).
- II.** Të dëmtuarit R.H. nga lagja . . pa nr. K-Prishtinë dhe Gjilil Kalimashi nga lagja Arbana k-Prizren për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil.
- III.** Shpenzimet e procedurës penale dhe taksa për viktimat e krimit bie barre e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur akuzë PP/l.nr.05/13 të datës 11.11.2014 kundër të pandehurit G. Sh. nga fsh. . . . k-Rahovec, për shkak të dy veprave penale dëmtim i kreditorëve apo debitorëve nga neni 235 paragraf 3 lidhur me paragraf 1 të KPK (UNMIK/RREG/2003/25), dhe dy veprave penal të mashtrimit nga neni 261 paragraf 2 lidhur me paragraf 1 të KPK (UNMIK/RREG/2003/25).

Gjykata Themelore në Gjakovë – DKR gjatë pas pranimit të kësaj aktakuze me dt.29.06.2023 (*edhe pse kanë kaluar me shumë se 9 vite*) ka shikuar dhe ka analizuar se a i plotëson kushtet aktakuza PP/l.nr.05/13 të datës 11.11.2014 që të ndërmerren veprime procedurale përkatësisht të caktohet shqyrtimi fillestare në këtë çështje penale.

Gjykata Themelore në Gjakovë- Departamenti për Krime të Rënda, pas shikimit të shkresave të lëndës të bashkangjitura me aktakuzë ka konstatuar se në këtë çështje penale me datë 07.05.2013, kanë filluar hetimet nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, kundër të pandehurit G.Sh. për shkak të dy veprave penale dëmtim i kreditorëve apo debitorëve nga neni 235 paragraf 3 lidhur me paragraf 1 të KPK (UNMIK/RREG/2003/25), dhe dy veprave penal të mashtrimit nga neni 261 paragraf 2 lidhur me paragraf 1 të KPK (UNMIK/RREG/2003/25). ndërsa me datën 11.11.2014 ka ushtruar aktakuzën në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

Gjykata Themelore në Gjakovë, DKR pas shikimit dhe analizimit të shkresave të bashkangjitura në aktakuzën PP/l.nr.05/13 të datës 11.11.2014 kundër të pandehurit G. Sh. nga fsh. . . . k-Rahovec, ka shikuar dhe ka bërë vlerësimin se aktakuza PP/l.nr.05/13 të datës 11.11.2014 a është një parashtrese e rregullt dhe a i plotëson kushtet ligjore të procedohet me caktimin e shqyrtimin fillestar.

Gjykata ka konstatuar se gjatë zbatimit të hetimeve Prokuroria Themelore në Gjakovë ka ndërmarrë këto veprime hetimore ku me dt.14.04.2014 e ka marrë në pyetje të dëmtuarin R.H. dhe të dëmtuarin Gj.K., ku gjatë marrjes në pyetje të këtyre dëmtuarve kanë marrë pjesë prokurori nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, të dëmtuarit dhe procesmbajtësja, ndërsa nuk kanë qenë të njoftuar i pandehuri dhe as mbrojtësi i të pandehurit për datën dhe orën e marrjes në pyetje të dëmtuarve në cilësinë e dëshmitarëve (ky njoftim është i parapare në nenin 132 paragraf 5 të KPK - *KODI Nr. 04/L-123 I PROCEDURES PENALE* ku është parapare “*Prokurori i shtetit e njofton me shkrim pesë (5) ditë më herët të pandehurin, mbrojtësin, të dëmtuarin dhe mbrojtësin e viktimave lidhur me datën, kohën dhe vendin ku do të merret deklarata në procedurë paraprake. Kopje e njoftimit i bashkëngjitet shkresave të lëndës*”).

Gjykata duke u bazuar në nenin 151 të KPPK ku është parapare “*Marrja në pyetje e të pandehurit në procedurë paraprake*”, ndërsa në paragrafin 1 të nenit 151 të KPPK - KODI Nr. 04/L-123 është parapare (*Para ngritjes së aktakuzës, i pandehuri merret në pyetje në seancën e marrjes së deklaratës në procedurë paraprake....*) pastaj bazuar në nenin 152 dhe nenin 154 të KPPK -KODI Nr. 04/L-123, ka konstatuar se marrja në pyetje e të pandehurit në procedurën paraprake para ngritjes së aktakuzës ka qenë veprim

procedural i detyruar i prokurorit (për veprat penale që parashihet dënim me burgim me shumë se tre vite), ka qenë dashur të merren në pyetje të pandehurit dhe në bazë të nenit 154 paragraf 8 të KPPK -KODI Nr. 04/L-123 ku është parapare (*Marrja në pyetje të pandehurit duhet t'i ofrojë mundësinë për t'i kundërshtuar arsyet e dyshimit kundër tij dhe për të nxjerrë në pah faktet që janë në favor të ti*), ti epet mundësia të pandehurit për ti kundërshtuar arsyet e dyshimit kundër tij dhe për ti nxjerrë në pah edhe faktet që shkojnë në favor të pandehurit, pra gjykata konstaton se parregullsia e kësaj aktakuze është se i pandehuri nuk është marre në pyetje në procedurën paraprake para ngritjes se aktakuzës.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat e konform nenit 442 te KPPK, pastaj në nenet 151, 152 dhe 154 te KPPK, ka vendosur dhe aktakuzën PP/l.nr.2/2013 të dt.10.11.2014 kundër të pandehurit G. Sh. nga fsh. . . k-Rahovec, për shkak të veprës penale dëmtim i kreditorëve apo debitorëve nga neni 235 paragraf 3 lidhur me paragraf 1 të KPK (UNMIK/RREG/2003/25), dhe dy veprave penal të mashtrimit nga neni 261 paragraf 2 lidhur me paragraf 1 të KPK (UNMIK/RREG/2003/25), e ka hudhur sepse gjatë zbatimit të hetimeve para përpilimit të kësaj aktakuze nuk janë ndërmarrë të gjitha veprimet e parapara ligjore.

Gjykata në bazë të nenit 462 paragraf 3 te KPPK të dëmtuarit R. H, nga lagja . . . pa nr. K-Prishtinë dhe Gj.K. nga lagja Arbana k-Prizren për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Gjykata në bazë të nenit 453 të KPPK shpenzimet e procedurës penale dhe taksa për viktimat e krimit bie barre e mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.227/2014 datë 03.06.2024**

**Zyrtarja Ligjore,
Miranda Ibrahim**

**Kryetari i Trupit Gjykes - Gjykatësi
Sultan Dobraj**

KËSHILLË JURIDIKE : Kundër këtij Aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 3 ditësh, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmes të kësaj Gjykate.